



Funded by  
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

### RAPORT MUJOR I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË KQZ

Janar 2021

Projekti:

*“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian.*

Ky raport u prodhua në kuadër të nismës “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjesi vetëm e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.



Funded by  
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



---

*Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij dhe kryerjes së monitorimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 25 Prilli 2021, është i angazhuar në vëzhgimin dhe monitorimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe organeve përbërëse. Më poshtë, parashtrohet përmbledhja e monitorimit të kryer gjatë periudhës Janar 2021.*

---

### **Përmbledhje Ekzekutive**

1. KQZ ka miratuar programin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. KShH vlerëson se ky proces duhet të kishte nisur zbatimin më herët, për shkak të rëndësisë së ndërgjegjësimit në kohë të zgjedhësve mbi kontrollin e listave të zgjedhësve dhe të dhënave të tyre. Vërehet se KQZ ka përfshirë një bashkësi mjaft shteruese të kanaleve të komunikimit, si edhe ka përcaktuar qartazi qëllimet e informimit dhe strukturën e fushatës së informimit. Vërehet se strategjia e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve nuk përfshin në mënyrë të saktë dhe të plotë treguesit cilësorë apo sasiorë të vlerësimit të efektivitetit dhe performancës së programit edukativ;
2. Për sa i përket emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, partia më e madhe e shumicës ka propozuar 91 gra dhe 139 burra, pra respektivisht 39.56% dhe 60.44%. Ndërsa partia më e madhe e opozitës ka propozuar 69 gra dhe 161 burra, respektivisht 30% dhe 70%. Vërehet se të dyja partitë janë në përputhje të dispozitës ligjore që kërkon 30% të anëtarëve të propozuar të jenë nga secila gjini. Ama, duke patur parasysh që dispozita ligjore vendos vetëm një dëshemë të përfaqësimit të barabartë gjinor në 30%, subjektet politike duhen nxitur për të garantuar një barazi gjinore më të qënësishme në procesin zgjedhor;
3. Në vlerësimin e KShH-së dhe nisur nga përvojat e mëparshme të procesit zgjedhor, gjykohet se do ishte dobiprurës zhvillimi nga ana e KQZ-së i trajnimeve paraprake për anëtarët e KZAZ-ve për të përforcuar njohjen e tyre të dispozitave të Kodit Zgjedhor,



Funded by  
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



organizimin e veprimtarisë së KZAZ-ve dhe administrimin e procesit zgjedhor. Kodi Zgjedhor, në nenin 14, ngarkon Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve me trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë.

Përgjatë muajit Janar 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimet e mëposhtme në kuadër të procesit zgjedhor:

- Vendim nr. 04, datë 07.01.2021 “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ, të vulës së KQV, vulës së kryetarit të KQV, dhe të vulës Rezervë”;
- Vendim nr. 5, datë 07.01.2021 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për përcaktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ”;
- Vendim nr. 6, datë 07.01.2021 “Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore”;
- Vendim nr. 9, datë 19.01.2021 “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;
- Vendim nr. 13, datë 25.01.2021 “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16.12.2020 ‘Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”;
- Vendim nr. 14, datë 25.01.2021 “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”;
- Vendim nr. 15, datë 25.01.2021 “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.



Funded by  
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Ndër to, KShH është angazhuar në vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe monitorimit të zbatimit të akteve të mëposhtme:

**I. Vendim nr. 9, datë 19.01.2021 “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”**

Sipas nenit 19, paragrafi I, gërma “g” të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve.

Programi i miratuar përqëndrohet në tetë tematika të caktuara: (i) informimi dhe sensibilizimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit; (ii) informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit; (iii) informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit; (iv) sensibilizimi i grave dhe të rinjve votues për here të parë për pjesëmarrje; (v) informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre; (vi) informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet; (vii) financimi i partive politike dhe zbatimi i legjislacionit; dhe (viii) informimi i emigrantëve, procedurat e regjistrimit për të votuar, si edhe mënyra e votimit nga vendbanimi i tyre i përhershëm. Ndërkohë, KQZ ka gjithashtu paraqitur kanalet e komunikimit nëpërmjet të cilave do kryhet shpërndarja e materialeve të informimit: (i) spote televizive; (ii) spote radiofonike; (iii) media online; (iv) rrjetet sociale; dhe (v) material promocionale në terren (gazeta, postera, *billboard*, *city light*, fletëpalosje). Vërehet se KQZ ka përcaktuar një bashkësi mjaft shteruese të kanaleve të komunikimit, si edhe ka përcaktuar qartazi qëllimet e informimit dhe strukturën e fushatës së informimit. Vlen të theksohet se duke marrë në konsideratë kufizimet e vendosura në përgjigje të pandemisë COVID-19, zgjedhësit janë më tepër të ekspozuar ndaj kanaleve digjitale të komunikimit, ndaj dhe është e rekomandueshme që fushata e informimit të përshtatet në përputhje me rrethanat.

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor nuk parashikon afat për publikimin e programit apo nisjen e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve, KShH vlerëson se ky proces duhet të kishte nisur zbatimin më herët, për shkak të rëndësisë së ndërgjegjësimin në kohë të zgjedhësve mbi kontrollin e listave të zgjedhësve dhe të dhënave të tyre. Gjithashtu, vërehet se strategjia e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve nuk përfshin në mënyrë të saktë dhe të plotë treguesit cilësorë apo sasiorë të vlerësimit të efektivitetit të programit edukativ. Nëpërmjet vëzhgimit të kryer nga KShH në Tiranë dhe qarqe përgjatë muajve tetor dhe dhjetor, gjetjet e të cilit janë ndarë me KQZ-në, është vërejtur se zgjedhësit nuk kanë shfaqur interes në konsultimin e listave zgjedhore, çka mund të rezultojë në kalimin e afateve ligjore për të kërkuar ndryshimin e të dhënave apo përfshirjen e të dhënave të zgjedhësve në listat zgjedhore.



Funded by  
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



## **2. Vendim nr. 14, datë 25.01.2021 “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”**

Në nenin 29, paragrafi I të Kodit Zgjedhor parashikohet se KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja. Në vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor” të Komisionit Rregullator, përcaktohet në nenin 7, paragrafi 5 se Komisioneri, jo më vonë se 93 ditë nga data e zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve (i.e. 22.01.2021). Pra, Komisioneri, me nxjerrjen e vendimit për emërimin e anëtarëve me datë 25.01.2021 nuk rezulton të ketë respektuar afatin e parashikuar në vendimin nr. 05 të Komisionit Rregullator.

Në neni 6, paragrafi I të vendimit nr. 05 të Komisionit Rregullator, parashikohet se *partitë politike që kanë të drejtën të propozojnë anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve depozitojnë në KQZ listën me propozimet dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve në shkallë vendi, jo më vonë se 105 ditë nga data e zgjedhjeve (i.e. 11.01.2021)*. KQZ, me anë të njoftimit në faqen e saj zyrtare të internet të datës 11.01.2021, njofton se 4 partitë politike që kanë të drejtën për të propozuar anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, sipas parashikimeve të vendimit nr. 40 datë 23.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e partive që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve” i kanë depozituar propozimet e tyre me datë 11.01.2021. Pra, vërehet se partitë politike janë në përputhje me afatin ligjor.

Sipas nenit 29, paragrafi I, shkronja ç të Kodit Zgjedhor, 30 përqind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga *partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini*. Sipas përlllogaritjes nga vëzhgimi i listës së personave të emëruar bashkangjitur vendimit nr. 14 të Komisionerit, rezulton se Partia Socialiste, si partia më e madhe e shumicës, ka propozuar 91 gra dhe 139 burra, pra respektivisht 39.56% dhe 60.44%. Ndërsa, Partia Demokratike, si partia më e madhe e opozitës, ka propozuar 69 gra dhe 161 burra, respektivisht 30% dhe 70%. Vërehet se të dyja partitë janë në përputhje të dispozitës ligjore të lartpërmëndur. Ama, duke patur parasysh që dispozita ligjore vendos vetëm një dyshe me të përfaqësimit të barabartë gjinor në 30%, subjektet politike duhen nxitur për të garantuar një barazi gjinore më të qënësishme.

Në vendimin nr. 14 të Komisionerit shprehet se Partia Social Demokrate, e cila ka të drejtën të propozojë një anëtar për 92 KZAZ, ka depozituar propozimet për 41 anëtarë, nga të cilët, sipas KQZ-së, 33 plotësojnë kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm. Në vijim do monitorohet plotësimi i 59 pozicioneve të mbetura sipas parashikimeve të nenit 29, paragrafi 5 të Kodit Zgjedhor.



Funded by  
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



### **3. Vendim nr. 15, datë 25.01.2021 “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”**

Sipas nenit 28, paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor merret nga KQZ-ja jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve (i.e. 25/01/2021). Vërehet se afati ligjor është respektuar nga KQZ e cila ka miratuar vendimin për ngritjen e KZAZ-ve në afatin e fundit.

Në vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor” të Komisionit Rregullator, përcaktohet në nenin 20, paragrafi 1 se mbledhja e parë e KZAZ-së thirret me vendim të Komisionierit. Vërehet se vendimi nr. 15 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është gjithashtu në përmbushje të këtij detyrimi.

Në nenin 8, paragrafi 2 të vendimit nr. 05 të Komisionit Rregullator parashikohet se vendimi i Komisionerit për ngritjen e KZAZ-ve përcakton njësinë administrative, selinë dhe orën kur do të zhvillohet mbledhja e parë e KZAZ-ve. Në vendimin e Komisionerit gjenden të reflektuara elementët e sipërpërmendur por vërehet se Komisioneri ka përcaktuar një shtrirje kohore në të cilën mund të zhvillohet mbledhja (09:00 – 17:00), jo një orë të caktuar siç kuptohet dhe parashikohet në vendimin e Rregullatorit. Pavarësisht se KZAZ-t kanë detyrimin të njoftojnë paraprakisht për zhvillimin e mbledhjes, mospërcaktimi i saktë i orës së zhvillimit nga Komisioneri, siç kërkohet në vendimin e Komisionit Rregullator, vështirëson koordinimin e monitorimit të mbledhjeve nga ana e institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile. Në vlerësimin e KShH-së dhe nisur nga përvojat e mëparshme të procesit zgjedhor, gjykohet se do ishte dobiprurës zhvillimi nga ana e KQZ-së i trajnimeve paraprake për anëtarët e KZAZ-ve për të përforcuar njohjen e tyre të dispozitave të Kodit Zgjedhor, organizimin e veprimtarisë së KZAZ-ve dhe administrimin e procesit zgjedhor. Kodi Zgjedhor, në nenin 14, ngarkon Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve me trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë.

Në nenin 93, paragrafi të Kodit Zgjedhor parashikohet se qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave, për aq sa është e mundur, krijohen në ndërtesa publike me hyrje të lirë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vendimin nr. 15 përcakton adresat e selive të KZAZ-ve ku këto të fundit do ushtrojnë aktivitetin. Sipas një vëzhgimi paraprak, vërehet se selitë e KZAZ-ve janë përcaktuar në ndërtesa publike (qendra kulturore, shkolla, kopsht, pallat sporti, pallat kulture, biblioteka, zyra arsimore, muze, salla sportive, teatër). Ky vëzhgim do i nënshtrohet një verifikimi në terren nëpërmjet vëzhguesve të KShH-së, i cili do ndihmojë në përcaktimin e përputhshmërisë ligjore të kësaj dispozite.